

VENDIM
Nr. 394, datë 10.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT
MINISTRINË E MJEDISIT DHE MINISTRINË E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS PËR DHËNIEN ME KONCESION TË NDËRTIMIT TË
LANDFILLIT PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE TË QARKUT TË Durrësit DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE
QË I JEPET SHOQËRISË “ALBANIA LANDFILL ENERGY A.L.E.”**

(Ndryshuar me VKM nr. 497, datë 22.7.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 96 663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritete kontraktuese për kryerjen e procedurave ligjore dhe dhënien me koncesion të ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane të qarkut të Durrësit janë: *Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*

2. Miratimin e bonusit prej 6% të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, si propozim i pakërkuar, që i jepet shoqërisë “Albania Landfill Energy A.L.E.”.

3. Ngarkohen *Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha